



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°23/2022

Hagë, 16/06/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 13 qershor, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese lëshoi vendimet në lidhje me kërkesat referuese të z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Krasniqi.

Z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Krasniqi pretenduan shkelje të të drejtave themelore të tyre dhe ngritën kundërshtime, ndër të tjera, lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara për të gjykuar çështje në lidhje me formën e përgjegjësisë penale individuale të njohur si “ndërmarrje kriminale e përbashkët”, zbatimin e drejtpërdrejtë të së drejtës zakonore ndërkombëtare, deri në çfarë mase duhet të kenë lidhje akuzat me raportin e miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, dhe caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e apelit të ndërmjetëm të z. Thaçi.

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese hodhi poshtë të tri kërkesat referuese si aktualisht të parakohshme. Me fjalë të tjera, para përfundimit të procesit kundër tyre, tre individët në fjalë nuk mund të parashtrojnë se janë viktima të shkeljeve që pretendojnë, duke qenë se ende nuk është marrë vendim në lidhje me pafajësinë ose fajësinë e tyre për akuzat e ngritura kundër tyre.

Dhoma hodhi poshtë ankesën e z. Thaçi lidhur me përbërjen e panelit të Gjykatës së Apelit të caktuar për shqyrtimin e apeleve të tij në lidhje me paraburgimin, dhe konfirmoi arsyetimin e Kryetare Trendafilovës nga vendimet e mëparshme se gjykatësit nuk caktohen në panele të përhershme për apele të ndërmjetme në një çështje gjyqësore, por caktohen në panel për secilin apel të ndërmjetëm më vete, dhe se kjo është praktikë e rrënjosur në Dhomat e Specializuara.





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°23/2022

Hagë, 16/06/2022

Dhoma vlerësoi në parim pyetjen themelore nëse juridiksioni i Dhomave të Specializuara, sikurse përcaktohet në Ligj, kufizohet vetëm në përmbajtjen e Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe konstatoi se “duke qenë se akuzat duhet të lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës, një lidhje e tillë duhet të kuptohet si lidhje që merr parasysh përmbajtjen dhe kontekstin e përshkruar në Raport dhe detyrimet ndërkombëtare të Kosovës që burojnë nga Raporti. Me fjalë të tjera, veprat e rënda për t’u shqyrtuar duhet të kenë lidhje me përmbajtjen dhe kontekstin e Raportit, i cili ndër të tjera paraqiti një tablo përgjithësisht shqetësuese të situatës në Kosovë, duke përfshirë mungesën e llogaridhënies për veprime kriminale të rënda.”

Në çështjen e z. Gucati dhe z. Haradinaj, më 15 qershor paneli i Gjykatës së Apelit miratoi pjesërisht kërkesën e z. Haradinaj për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve për parashtrimin e njoftimit për apel kundër aktgjykimit të trupit gjykues për shkak të çështjeve komplekse ligjore që dalin nga aktgjykimi.

Paneli konstatoi se kërkesa nuk është bërë në kohën e duhur sepse afati për parashtrimin e njoftimeve për apel është data 17 qershor 2022, dhe në këtë kontekst theksoi se palët morën kopje të legalizuar të aktgjykimit më 18 maj. Megjithatë, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjeve të ngritura në aktgjykim, paneli u miratoi si z. Haradinaj, ashtu edhe palëve të tjera në proces, tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve me 800 fjalë.

**Pyetje nga gazetarët  
Nuk pati pyetje.**

